4556
20 12 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK SHKODËR

Nr.22/18 Prot

Shkodër, më 15.12.2021

Lënda: Njoftim për shpalljen e lëvizjes paralele.

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Ofruesi publik i AFP-së, Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Shkodër, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Instruktor/mësimdhënës i formimit teoriko-praktik me kohë të pjesshme për kursin "Start - Smart". (1 mësimdhënës)

a) Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

1. **Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicioni:
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës ..28.12.2021.

DREJTOR

Irma LOHJA